



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.12/1

Datë 1 mars 2006

P Ë R M B A J T J A

Vendim i GJK
nr.3, datë 20.2.2006

Mendimi
pakicës.....

Faqe

i 417

MENDIMI I PAKICËS

Nuk mund të bashkohem me shumicën e Gjykatës, e cila ka konkluduar se pika 6 e nenit 42 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, duhet të shfuqizohet si në kundërshtim me Kushtetutën, për arsyet që vijnë:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 145/2 të Kushtetutës, ia kanë referuar çështjen Gjykatës Kushtetuese për t’u shprehur lidhur me kushtetutshmërinë e kreut V të ligjit të mësipërm “Për pushtetin gjyqësor ...”, duke arsyetuar në esencë, se me përcaktimin e rasteve konkrete të shkarkimit të gjyqtarit, Kushtetuta nënkupton se nuk ka lejuar delegimin e kësaj kompetence, ligjvënësit të zakonshëm..., dhe se ... duke analizuar vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, konstatohet se, me “mospërbushje të rregullt të detyrës” (pika 7 e nenit 41 të ligjit), është kuptuar dhënia e një vendimi të gabuar (kur është prishur nga organi më i lartë) ose që cilësohet si i gabuar nëpërmjet kontrollit të inspektoratit.

Në këtë mënyrë, rasti i referuar nga Gjykata e Lartë, ngre çështjet të tilla si, nëse neni 147 i Kushtetutës e autorizon ligjvënësin të detajojë rastet e shkarkimit të gjyqtarit nga detyra, nëse përcaktimi i shkeljeve disiplinore në nenin 41 të ligjit të kundërshtuar, është në tejkalim të përcaktimeve kushtetuese, dhe nëse interpretimi nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i pikës 7 të nenit 41 të ligjit të atakuar, nëpërmjet vendimeve të marra nga ky Këshill, është në kundërshtim me Kushtetutën.

Pavarësia e gjyqtarëve (neni 145 i Kushtetutës) në shtetin e së drejtës është një parim që orientohet nga vlerat themelore të rendit kushtetues. Pikërisht, detyrimi i përgjithshëm për dhënien e drejtësisë e imponon garantimin e këtij parimi. Megjithatë, pavarësia gjyqësore nuk përbën një privilegj për gjyqtarin. Ajo nuk i jep dorë të lirë për veprim të pakufizuar, por ushtrohet në kuadrin e përcaktimeve kushtetuese e ligjore. Në kuadrin e parimit të sovranitetit popullor (neni 2/1/2 i Kushtetutës), pushtetet e qeverisjes ushtrohen si pushtete të deleguara, gjë që do të thotë se ato (pushtetet) nuk ushtrohen si konkurrim, por në kuadrin e një ndërveprimi të përbashkët funksional (neni 7 i Kushtetutës).

Garantimit të këtij parimi i shërbejnë një sërë rregullimesh kushtetuese e ligjore, të tilla që kanë të bëjnë me organet që janë ngarkuar me transferimin dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve (nenet 136 e 147 të Kushtetutës), me kohën e qëndrimit në detyrë, me pagat (neni 138 i Kushtetutës), me imunitetin e gjyqtarëve (neni 137 i Kushtetutës), etj.

Përveç sa sipër, aspekte të rëndësishme të mbikëqyrjes gjyqësore, Kushtetuta ia ka rezervuar ligjit. Kështu, në bazë të nenit 147/4 të Kushtetutës, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendos për ... përgjegjësinë e tyre (të gjyqtarëve) disiplinore **sipas ligjit**. Ky formulim i kësaj dispozite nënkupton se mjaft aspekteve të përgjegjësisë disiplinore, duke përfshirë edhe detajimin e shkeljeve të disiplinës dhe të sanksioneve përkatëse disiplinore, Kushtetuta ia ka lënë ligjvënësit të zakonshëm. Përveç kësaj, edhe mënyra parimore dhe e përgjithshme e formulimit kushtetues (neni 147/6) dikton nevojën e detajimit me ligj. Një gjë e tillë është e nevojshme edhe për të përmbushur një standard të kërkuar në këtë drejtim, që rastet e përgjegjësisë dhe sidomos të shkarkimit të gjyqtarëve të jenë sa më të detajuara në legjislacionin që rregullojnë përgjegjësinë e tyre disiplinore, gjë që do të minimizonte diskrecionin e tepërt të organit disiplinor.

Lidhur me çështjen, nëse përcaktimi i shkeljeve të disiplinës në nenin 41 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor ...” është në kundërshtim me Kushtetutën, është e nevojshme të konfrontohet kjo dispozitë e ligjit me nenin 147/6 dhe dispozita të tjera të Kushtetutës. Duke i analizuar rastet e shkarkimit, të parashikuara në nenin 147/6 të Kushtetutës, konstatohet se neni 41 i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka detajuar njërin nga rastet e shkarkimit që parashikon kjo dispozitë, dhe pikërisht shkarkimin për **akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit**. Pra, siç shihet nga njëra anë, dispozita kushtetuese shprehet për **“akte dhe sjellje”**, të cilat mund të jenë nga më të ndryshmet, por nga ana tjetër, e ngushton marzhin e tyre, duke vendosur kushtin që këto **“akte e sjellje”** duhet të jenë bërë shkak për **“diskreditimin e rëndë të pozitës dhe figurës së gjyqtarit”**. Në këtë mënyrë, dispozita kushtetuese ka përcaktuar vetëm standardin se kur shkeljet disiplinore mund të passjellin shkarkimin e gjyqtarit. Në rastin në shqyrtim, duke i parë rastet e shkeljes së disiplinës të parashikuara nga dispozita e mësipërme e ligjit, mendoj se formulimi i saj është brenda këtij standardi kushtetues.

Lidhur me nenin 42 të ligjit të kundërshtuar, mendoj se edhe kjo dispozitë është në pajtim me Kushtetutën. Në këtë dispozitë ligjvënësi i zakonshëm vetëm sa ka precizuar llojet e sanksioneve disiplinore që mund të imponohen ndaj gjyqtarit dhe që fillojnë me atë të vërejtjes dhe mbarojnë me atë më të rëndin, që është shkarkimi nga detyra, sanksion ky, që parashikohet edhe në Kushtetutë (neni 147/6). Për pasojë, përderisa sanksioni më i rëndë rregullohet nga Kushtetuta, atëherë nuk vihet në dyshim se edhe ato më të lehtat janë në pajtim me Kushtetutën. Përveç kësaj shfuqizimi i pikës 6 të nenit 42, do të krijojë përshtypjen sikur ligji “Për pushtetin gjyqësor ...” nuk e parashikon sanksionin disiplinor të shkarkimit, gjë që do të krijonte keqkuptime në këtë drejtim, sepse një sanksion që e rregullon Kushtetuta nuk është jokushtetues që të adaptohet edhe në ligj.

Megjithatë, mendoj se nga pikëpamja e formulimit, neni 42 i ligjit “Për pushtetin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka vend për përmirësim. Së pari, formulimi ekzistues duhet të adaptonte standardin kushtetues, që lidhet, në mënyrë të veçantë, me masën e shkarkimit të gjyqtarit nga detyra, dhe konkretisht, atë që ka të bëjë me **diskreditimin e rëndë** të pozitës dhe figurës. Konkretisht, në këtë nen, pasi numërohen sanksionet nga “vërejtja” deri tek “transferimi ...”, i cili do të ishte paragrafi i parë i këtij neni, në paragrafin e dytë mund të parashikohej se “kur shkeljet e disiplinës, të parashikuara në nenin 41 të këtij ligji, gjykohet se kanë diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, ndaj tij mund të merret masa e shkarkimit nga detyra. Sidoqoftë, mendoj se kjo mangësi nuk e bën jokushtetuese këtë dispozitë, sepse plotësohet nga neni 46 i ligjit. Sipas kësaj dispozite: “Gjyqtari që shkarkohet nga detyra **për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë**, ka të drejtë të ankohej ...”. Ky formulim nënkupton se shkeljet e disiplinës të përcaktuara nga neni 41 i ligjit, mund të përbëjnë shkak për shkarkim vetëm kur kanë sjellë **diskreditim të rëndë të pozitës dhe të figurës**, gjë që vlerësohet rast pas rasti nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë apo Gjykata e Lartë. Pra, jo çdo shkelje e disiplinës, që parashikon neni 41 mund të sjellë shkarkimin e gjyqtarit, por organi disiplinor (Këshilli i Lartë i Drejtësisë) dhe Gjykata e Lartë, duke kombinuar nenin 41 me nenin 46 të ligjit, për të konkluduar nëse sjelljet e parashikuara në dispozitën e parë përbëjnë shkak për shkarkim nga detyra, duhet të verifikojnë nëse këto shkelje kanë **diskredituar rëndë** pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

Në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është vënë në dyshim edhe kushtetutshmëria e interpretimit, nga ana e organit disiplinor (Këshilli i Lartë të Drejtësisë), të pikës 7 të nenit 41 të ligjit, dispozitë kjo, që ka të bëjë me shkeljen e disiplinës nëpërmjet **kryerjes së veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës ose moskryerja e veprimeve të detyrueshme procedurale, kur nuk përbën vepër penale**. Është e vërtetë se gjendja e jokushtetutshmërisë mund të shkaktohet si nga vetë ligji, që mund të jetë jokushtetues, por edhe në procesin e aplikimit të ligjit. Rasti i fundit ka të bëjë me atë që, megjithëse ligji, në vetvete, është në pajtim me Kushtetutën, organi që e aplikon, p.sh., organi disiplinor, gjykata, e interpretojnë në mënyrë jokushtetuese.

Në këtë drejtim mendoj se kontrolli i veprimtarisë së gjyqtarit, bashkë me pasojat që rrjedhin prej kësaj për karrierën e tij të mëtejshme profesionale, është mjaft delikat nga pikëpamja kushtetuese. Këtu është fjala për raportin e tendosur midis pavarësisë së gjyqësorit, apo pavarësisë së gjyqtarit në dhënien e vendimeve, dhe mbikëqyrjes së gjyqtarit, që buron nga detyrimi i shtetit për të garantuar një drejtësi efektive. Standardi që pajton këto interesa në konflikt është që mbikëqyrja ndaj gjyqtarit nuk duhet të vërë në dyshim vendimet e dhëna nga gjyqtari që janë rezultat i bindjes së brendshme të tij. Kjo çështje verifikohet, rast pas rasti, nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë apo e Gjykatës së Lartë në interpretim të pikës 7 të nenit 41 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor ...” duke parë se cilat **veprime të gjyqtarit** cilësohen si **në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës**. Në hipotezë të cilësimit si të tilla të rasteve, aplikimit të gabuar të ligjit, në një çështje që gjyqtari ka pasur për shqyrtim, një interpretim i tillë i kësaj dispozite të ligjit (pika 7 e nenit 41) do të ishte jokushtetuese, sepse prek parimin e pavarësisë së gjyqtarit. Kjo për arsye se, aspekti më i rëndësishëm i kësaj pavarësie, është respektimi i bindjes së brendshme të gjyqtarit. Në rast se vendimet që janë rezultat i aplikimit të gabuar të ligjit, nuk janë raste të shkëputura për një gjyqtar të caktuar, atëherë mund të ballafaqoheshim me paaftësinë profesionale të gjyqtarit, gjë që mund të përbëjë shkak për largimin nga detyra, por një gjë e tillë kërkon një vlerësim në tërësi të aftësisë profesionale të tij. Vendimet e gabuara mund të nxisin marrjen e masës së shkarkimit ndaj gjyqtarit, vetëm kur vërtetohet se ato janë rezultat i ndërhyrjeve nga jashtë mbi gjyqtarin, p.sh., kur vendimi është rezultat i mitmarjes apo i privilegjeve të tjera të përfituara prej tij. Sidoqoftë, influenca mbi gjyqtarin duhet të provohet, sepse vetëm fakti i vendimit gjyqësor të gabuar nuk mund të çojë në shkarkimin e gjyqtarit.

ANËTAR
P. Plloçi

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 042 555 63; ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN	1500
PUBLIK.....	
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
.....	
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET...(suplement	1500
2006).....	
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I	1500
LEGJISLACIONIT.....	
2. TREGUESI TEMATIK I	2000
LEGJISLACIONIT.....	

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI	1000
DOGANOR.....	
3. KODI DETAR	1000
.....	

Doli nga shtypi më 1.3.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Mësonjëtorja”
Tiranë, 2006

Çmimi 50 lekë